



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT

MODULI: Edukimi Financiar

Tiranë, 2016



PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli	EDUKIMI FINANCIAR
Qëllimi i modulit	Një modul që zhvillon te nxënësi njohuri të thjeshta ekonomike dhe financiare si dhe i aftëson ata të jenë qytetarë të vetëdijshëm për të marrë vendime financiare duke vlerësuar kostot dhe përfitimet si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre si konsumatorë në tregun financiar.
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përshkruan institucionet financiare, funksionet dhe instrumentet e tyre në tregun financiar (12 orë)</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Kuptimi për kulturën financiare.- Karakteristikat e sistemeve ekonomike.- Tiparet e ekonomisë shqiptare.- Mjedisi financiar, politika fiskale dhe monetare.- Institucionet financiare, funksionet dhe politikat.- Shërbimet financiare <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje-përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë e kuptimin dhe rëndësinë e kulturës financiare;- të analizojë ndikimin që kanë vendimet financiare në standardin e jetesës së qytetareve;- të përshkruajë karakteristikat themelore të sistemeve të ndryshme ekonomike;- të përshkruajë tiparet e ekonomisë shqiptare;- të shpjegojë kuptimin mbi mjedisin financiar;- të dallojë institucionet financiare, funksionet dhe politikat e tyre;- të bëjë dallimin mes politikës fiskale dhe asaj monetare;- të shpjegojë të drejtat dhe detyrimet e individit si konsumator i shërbimeve financiare;

RM 2 Nxënësi kryen veprime të administrimit të financave vetjake (24 orë).

Përmbajtja:

- Vlera monetare e parasë.
- Inflacioni dhe kursi i këmbimit të parasë.
- Produktet dhe shërbimet bankare.
- Llojet e llogarive dhe depozitat bankare, norma e interesit.
- Llogaritë e kursimit, rrjedhëse dhe kredia.
- Kartat bankare
- Skema e sigurimit të depozitave;
- Kostot dhe përfitimet e kursimit dhe të huamarrjes;
- Raporti mes taksave, kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore dhe të ardhurave vetjake;
- Procedura e hartimit të buxhetit vetjak dhe plani i kursimit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë kuptimin mbi vlerën monetare të parasë;
- të analizojë efektet e inflacionit dhe të kursit të këmbimit mbi vlerën e parasë;
- të analizoje ndikimin e inflacionit në vendimmarrjet mbi financat vetjake;
- të përshkruajë llojet e produkteve dhe shërbimeve bankare;
- të shpjegojë kushtet për çeljen e një llogarie kursimi/rrjedhëse/ për përfitimin e një kredie;
- të përshkruajë kuptimin mbi llojet e llogarive dhe depozitave bankare;
- të llogarisë përfitimet nga depozita me afate dhe norma interesi të ndryshme;
- të krahasojë kostot dhe përfitimet nga përdorimi i depozitave të ndryshme;
- të shpjegojë dallimin mes kartave bankare, përfitimet dhe kostot e përdorimit të tyre;
- të shpjegojë skemën e sigurimit të depozitave si mbështetje dhe nxitje për kurse te sigurta;
- të analizoje kostot dhe përfitimet e kursimit;
- të analizoje kostot dhe përfitimet e huamarrjes;
- të dallojë ndikimin në të ardhurat vetjake të taksave, kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore;
- të dallojë ndikimin e taksave dhe tatimeve të pushtetit vendor në të ardhurat vetjake;
- të hartojë buxhetin vetjak;
- të vlerësojë ndjekjen/ zbatimin e bu e buxhetit vetjak;
- të hartojë plan kursimi;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të shkollës.
- Për realizimin e modulit nxënësi është i detyruar të kryejë të

dyja rezultatet mësimore të parashikuara në modul..

- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime të shembujve konkretë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me raste të administrimit të financave vetjake.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për veprimet financiare të parashikuara në modul. **Portofoli i nxënës/it,-es**, sugjerohet si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi dhe informacioni te prindët për progresin e nxënësit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen dhe materialet e mëposhtme:

- Materiale mbështetëse dhe fletë palosje të bankave.
 - Katallogë, manuale, udhëzuesë, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-